



REPUBLICA E KOSOVES  
REPUBLICA KOS.  
QENDRA PER SHERBIM TE QY  
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 12 Nr. 3/32  
U. \_\_\_\_\_ Br. \_\_\_\_\_

Nr. i faq. 4 Data: 07/02  
Br. str. \_\_\_\_\_ Datum: 2025

**REPUBLIKA E KOSOVES**  
REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**KOMUNA E KAMENICES**  
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



**Procesverbali i mbajtjes së takimit publik për projektin: 'Ndërtimi i objekteve të pashfrytëzuara komunale dhe adaptimi i tyre në bujtina malore në zonat rurale të Kamenicës: Feriqevë, Kranidell, Desivojcë.**

Takimi publik është organizuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë.

Njoftimet për qytetarë për organizimin e takimit janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në Eëbfaqen Komunale dhe në Facebook-un zyrtar të Komunës së Kamenices.

**Publikimet:**

**WEBFAQE:**

<https://kamenice.rks-gov.net/ep-content/uploads/2025/01/Takim-Publik.pdf>

**FACEBOOK:**

<https://www.facebook.com/KomunaKamenice/posts/pfbid037gDbAboq2x5ZiBKUNa1CAEgaJZzp4T2hQK2ZHeXrRkZKzFjNQPZKoL2cG5sKvS7PI>

**Me 07.02.2025** është mbajtur takimi publik me qytetarë në Sallën e Kuvendit Komunal duke filluar nga ora 10:00.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin: përfaqësues nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Drejtorë të Drejtorive komunale, qytetarë, zyrtarë komunal, OJQ dhe të tjerë.

Takimin e hapi Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik, Burbuqe Leka

“E kemi në planifikim të adaptojmë objekte komunale të pashfrytëzuara në veprimtari ku mendojmë që Komuna ka nevojë. Jemi fokusuar tek tri objekte të pashfrytëzuara, ku diku diku janë të rrënuara dhe do ti adaptojmë në bujtima malore. Lokacionet janë Feriqevë, Kranidell dhe Desivojcë dhe pas adaptimit të tyre mendojmë ti lidhim me sektorin privat. Shkaku pse këto lokacione janë infrastruktura dhe banorët që kanë shprehur interesim. Poashtu përveq që ti lidhim me sektorin privat këto bujtina kemi opsion edhe për thirrje publike si dhe me ndërmarrjen publike “Dardana” ”.

Arkitekti Ermal Canaj ka prezantuar projektin për objektet në fjalë.

“Vlerat mbidetare të këtyre vendeve bëjnë që të jenë të shfrytëzueshme për bujtina. Shkolla në Feriqevë me 115 m<sup>2</sup> është menduar që të jetë njëra nga bujtinat. Sipas planit deri në 19 turista mund të qëndrojnë në këtë bujtinë. Kosto për tu kthyer në bujtinë është 90 deri në 110 mijë euro”.

**Pas prezantimit të bujtinës së parë është hapur debati për pyetje.**

Sylejman Kallaba: A ka mundësi që ta ketë kuzhinën pasi që është zonë malore dhe tursitët e duan këtë?

Përgjigje Ermal Canaj:Ka metra pak dhe e kemi menduar vetëm për fjetje dhe hapësira e përbashkët që e kemi menduar të shfrytëzohet. Ndërsa kuzhinat do të jenë në Kranidell dhe Desivojcë.

Burbuqe Leka: Nëse duam ta kemi kuzhinën si ia bëjmë?

Përgjigje Ermal canaj:Heket dhoma e gjumit dmth 4 persona.

Burimi Mavriqi :Ide e mirë me kuzhinë të jetë funksionale me ujë. Të jetë mini kuzhinë, nuk prishë punë.

Përgjigje Ermal Canaj: Priset enterieri por mund të jetë tek depo një kuzhinë e vogël.

Ermal Canaj: Vazhdojmë me bujtinën e dytë. Është shkolla në Kranidell. 265 m<sup>2</sup>. Diku planifikohen 34 persona në të njëjtën kohë dhe ka edhe kuzhinë e poashtu edhe qëndrim për work shope. Vlera investive rreth 130 mijë Euro.

**Pas prezantimit të bujtinës së dytë është hapur debati për pyetje.**

Afrim Dervishi: Dhomat e kanë të gjitha banjot e integruar?

Përgjigje Eermal Canaj: Po të gjitha e kanë me banjo.

Besa Morina: Më ra më shumë në sy kostoja. Ku për Feriqevë ke deri në 110 mijë euro, ndërsa në Kranidell ku objekti ke më i madh ke deri në 130 mijë euro dmth jo shumë e bazuar?

Përgjigje Eermal Canaj: Për shkak që në Feriqevë do të hiqet edhe kulmi dhe do të bëhet i ri , ndërsa këtu vetëm do të rindërtohet.

Petrit Vokshi: Furnizimi me energji elektrike a do të bëhet me solare gjithë objekti apo vetëm ndihmesë?

Përgjigje Eermal Canaj: Vetëm ndihmesë sepse komplet është kosto shumë e lartë.

Burimi Mavriqi: Për ngrohje gjatë dimrit a është menduar për secilën?

Përgjigje Eermal Canaj: Gjatë dimrit do ta vendosim një kamin qëndror dhe ai do të parcejell ujin për secilën. Por kemi menduar edhe pompa termike e cila mund të shfrytëzohet edhe për ftohje gjatë verës. Por kjo vetëm nëse nuk aprovohet kamini nga inxhinierët.

Amir Rudaku: Puna e menaxhimit si do të jetë?

Përgjigje Burbuqe Leka: Mendojmë ta kemi publiko-privat, të ndërlidhet me sektorin privat. Por nëse nuk gjejmë ndonjë person e bëjmë edhe me thirrje publike.

Amir Rudaku: A keni planifikuar edhe ju si ndihmesë komunat participim apo vetëm sektori privat?

Përgjigje Burbuqe Leka: Ne do të rinovojmë por kur të përfundojnë menaxhimin ta bëjë sektori privat

Amir Rudaku: A mund të vendosim edhe ndonjë fshat tjetër si Poliqka, ku është një pjesë e ambulantës?

Përgjigje Burbuqe Leka: Do të vazhdojmë edhe me vende tjera, por njëherë e kemi këtë pilot projekt dhe do ta shohim si po shkon me këto vende dhe mandej e vazhdojmë me objektet tjera, ku në të ardhmen ta kemi një shtëpi për gratë e dhunuara, një shtëpi për pleq.

Përgjigje Eermal Canaj: Një problem tjetër që smund ti marrim vendet tjera është se objektet janë tejet të vjetra.

Eermal Canaj: Vazhdojmë me prezantimin e objektit të tretë. Objekti tjetër është në fshatin Divojcë shkolla ku është më e madhe sesa dy objektet tjera ku i ka 480 m2. Është shkollë e

madhe dhe ne ende nuk kemi ditur si ta destinojmë. Por diku 48 persona mund të vendosen dhe vlera investive është diku 210 mijë Euro.

**Pas prezantimit të bujtinës së tretë është hapur debati për pyetje.**

Alisahit Bunjaku: Keni bërë punë të mirë që ti adoptoni këto objekte. Është hap i qëlluar që komunës ti kthehet turzimi. Po ndalem tek Desivojca ku kam qenë bartës i ndërtimit të kësaj shkolle, është objekt me bazament tejet të qëndrueshëm dhe ka planimetri tejet të bukur. Kapacitetet e saj janë të mjaftueshme që të vazhdohet edhe një kat.

Ky objekt mund të adaptohet edhe për të moshuarit që të gjejnë strehim aty.

Muhamet Shkodra: Ideja ime ka qenë kjo dhe shpresoj të bëhet. Është mirë që të na i prezantoni në letër. Shkolla e Desivojcës ka mundësi edhe për kamping, është një lum, xhamija, ambullanta afër aty.

Përgjigje Burbuqe Leka: Ka qenë ideja që të jetë për grupe më të mëdha jo vetëm familjar. Shembull ne nxënësit i dërgojmë shpesh në shëtitje, apo ti ftojme edhe grupe nga vendet tjera që të vijnë të bëjnë ëork-shope.

Muhamet Shkodra: Është mirë të kenë përparësi njërëzit nga Kamenica së pari, sepse në të kaluarën njërëzit e huaj kanë shfrytëzuar asetet tona.

Përgjigje Burbuqe Leka: Ende nuk është përfunduar asgjë. Dy zonat e para janë të përfunduara ndërsa në Desivojcë ende kemi kohë.

Vehbi Kastrati: Shumë ide e qëlluar. Janë projekte për tu përshëndetur. Pjesa e Desivojcës mund të ishte mirë të bëhej ndonjë qendër rehabilituese pasi paska sipërfaqe të madhe, dhe të shkojnë të rehabilitohen ata që kanë probleme me frymarrje, probleme me zemër, pasi që në vendet përendimore këto vendet malore janë për këta persona, sepse i kanë edhe kushtet, klimën.

Poashtu nuk duhet përjashtuar edhe shkollën e Poliqkës, Lisockës, Ambullantën e Poliqkës. Edhe ato mund të bëhen qendra rehabilituese apo hotele. Pastaj shkolla e Gjyrishevcit.

Përgjigje Burbuqe Leka: Edhe këto që i përmende do t'iu vijë rendi. Por së pari do të vazhdojmë me këto trija si pilot projekt.


Alisahit Bunjaku: Në Desivojcë parashihet edhe penda e ujit dhe është mirë që t'i ofrohet sa më shumë kësaj bujtine, dhe do të rriste edhe më shumë vlerën e projektit.

Muhamet Shkodra: A ka ndonjë afat kohor kur do të përfundoj?

Përgjigje Burbuqe Leka: Ende nuk e kemi përfundimisht vlerën e gjithë projektit. Mendojmë të fillojmë në momentin që përfundohet projekti dhe të përfshihen komentet tuaja. Do të vazhdojmë menjëherë me tenderim.

Takimi ka mbaruar në orën: 11:00.

Procesmbajtës:



---